



# Raportim Vjetor

Përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë

## Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2014

Enkeleda Shehi,

Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive

27 prill, 2015

*Znj. Enkeleda Shehi, Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paraqet raportin vjetor përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të neneve 3, 13, 14, 16 dhe 28 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.*

Kryetar i Komisionit, z. Braçe; Zëvendëskryetar i Komisionit, z. Bode; Zonja e Zotërinj deputetë anëtarë të Komisionit,

Në përmbushje të detyrimit ligjor paraqes sot raportin vjetor mbi veprimtarinë e AMF-së<sup>1</sup> të zhvilluar gjatë vitit 2014. Në fjalën time do të përqendrohem në dy shtylla kryesore: (i) zhvillimet e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, dhe (ii) funksionimi i vetë institucionit të AMF-së.

---

<sup>1</sup> Raporti Vjetor, 2014, AMF.

Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2014 mund të themi se u karakterizua nga dy periudha kryesore:

- Gjysma e parë e vitit 2014 u përqendrua në aspektet e analizës së rreziqeve në tregjet financiare dhe konkludimit të rekomandimeve të FSAP-it, si edhe miratimit të paketës ligjore.
- Gjysma e dytë e vitit 2014 shërbeu për programin e detajuar të punës për zbatimin e rekomandimeve të FSAP-it, krijimit të kuadrit të përshtatshëm për zbatimin e paketës ligjore të miratuar dhe nisjes së projekteve të asistencës në mbështetje të objektivit të forcimit të kapaciteve administrative të AMF-së.

Që në fillim dëshiroj të theksoj se në vëmendjen tonë për programimin e punës kanë qenë kërkesat e paraqitura nga Kuvendi në rezolutën mbi vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2013, duke qenë të vetëdijshëm që një pjesë e tyre janë të natyrës afatmesme. Madje mund të shprehem se këto kërkesa kanë gjetur përmbushje të gjerë dhe në fjalën time në vijim shtjellohen problematikat e kësaj rezolute. Sigurisht që këto kërkesa nuk mund të quhen plotësisht të ezauruara, sepse siç e theksova janë të natyrës afatmesme dhe një pjesë e tyre janë përfshirë në projektet e asistencës.

Gjithashtu, AMF po zbaton rekomandimet e FSAP-it, të cilat shtrihen për të gjitha tregjet që mbikëqyr e rregullon AMF dhe i përkasin një periudhe afatmesme, e disa prej tyre dhe afatgjatë. Për rrjedhojë, ato, së bashku me rekomandimet e Raportit të Progresit, përbëjnë në fakt një plan afatmesëm veprimi për AMF-në dhe për këtë arsye raportimet në Kuvend për disa vite do të trajtojnë gjerësisht këtë element. Rekomandimet e FSAP-it dhe trajtimi i paketave ligjore kanë qenë gjerësisht pjesë e diskutimeve në Grupin Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF), anëtar i të cilit është AMF, të grupit teknik, si dhe të grupeve të posaçme të punës të krijuara me urdhër të Kryeministrit me këtë objektiv.

## **1. Tregjet financiare nën mbikëqyrje**

*Tregjet e sigurimeve, të kapitalit dhe fondeve të investimeve, si dhe të fondeve private vullnetare të pensioneve, që njihen me termin tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, kanë vijuar prirjen e tyre për zgjerim. Në vitin 2014, totali i aktiveve në këto tregje arriti në rreth 89 miliardë lekë, me një rritje prej 22% kundrejt vitit 2013. Për rrjedhojë, edhe kontributi i këtyre tregjeve në ndërmjetësimin financiar është rritur ndjeshëm. Treguesi i aktiveve gjithsej ndaj PBB-së për vitin 2014 arriti në nivelin më të lartë të vërejtur deri më sot prej 6.4%. Për të kuptuar më mirë këtë dinamikë, mjafton të kujtojmë që ky tregues në vitin 2013 arriti në 5.36% dhe në vitin 2012 ishte 2.75%.*

Në fund të vitit 2014 rezultojnë 475 licenca për ushtrim veprimtarie në tregjet që mbikëqyren nga AMF. Nga ky numër 57 janë licenca për shoqëri, përfshi edhe bankat; 5 licenca janë për fonde pensioni dhe investimi dhe 413 licenca janë për individë.

*Struktura e tregjeve në vitin 2014 konfirmoi ndryshimin strukturor të vërejtur në dy vitet e fundit. Kështu, tregu më i madh për t'u mbikëqyruar nga pikëpamja e aktiveve mbetet tregu i fondeve të investimeve. Pësia e këtij tregu në vitin 2014 në tregjet financiare që mbikëqyr AMF, arriti në 71.4%, nga 69% në vitin 2013.*

**Zgjerimi i shpejtë i tregjeve dhe ristrukturimi i tyre, bënë të nevojshme riformatimin e strukturës së funksionimit të AMF-së dhe forcimit të kapacitetit rregullator e mbikëqyrës.** Ishin pikërisht këto tipare që diktuan nevojën e kryerjes së amendimeve ligjore në ligjin e AMF-së dhe të dy ligjeve shoqëruese, për pagat dhe strukturat e institucioneve të pavarura, si dhe të shërbimit civil. Prandaj, miratimi i kësaj pakete ligjore nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2014 ishte një zhvillim mjaft pozitiv për AMF-në. Kjo paketë përmbushi nevojën e forcimit të pavarësisë së AMF-së, të shprehur prej vitesh, si dhe krijoi kushtet për forcimin e pavarësisë reale të AMF-së, bazuar në frymën e diskutimit të ligjvënësit, që shoqëroi miratimin e saj. Megjithatë, përfitimet nga ky status i përforcuar pavarësie është ende herët të shprehen për shkak të konstituimit me vonesë i Bordit të ri të AMF-së, duke mos lejuar ushtrimin e kompetencave përkatëse.

Duke u ndalur në veçanti në secilin prej tregjeve do të theksoja:

## **2. Tregu i sigurimeve**

**Tregu i sigurimeve, në raport me tregjet e tjera financiare,** gjatë tre viteve të fundit po paraqet një **situatë më të stabilizuar dhe në rritje**, me vëmendje kryesore në produktin e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe me nevojën për rritjen e shkallës së penetrimit, nëpërmjet zgjerimit të tregut të produkteve vullnetare. Shkalla e penetrimit megjithëse është rritur në 0.83% në vitin 2014, mbetet ende e ulët në raport me vendet e rajonit. Totali i aktiveve në vitin 2014 është rreth 1.8% e PBB-së, pothuaj sa një vit më parë. Ndërsa pësia kundrejt totalit të aktiveve të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, ka vijuar prirjen rënëse, duke arritur në 28%, nga 30% që ishte një vit më parë. Edhe numri i shoqërive të sigurimit u pakësua me një, si rrjedhojë e bashkimit me përthithje të dy shoqërive ekzistuese.

Por brenda tregut të sigurimeve, në ndryshim nga pozicionimi i tij kundrejt tregjeve të tjera financiare, vërehen disa dinamika pozitive. Kështu, *vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së nivelit të primit të produktit të sigurimit të detyrueshëm motorik.* Ky zhvillim ishte rrjedhojë e masave që u ndërmorën për të stabilizuar primet e shitjes në treg dhe për të mos i lënë të ndikoheshin nga konkurrenca e ashpër, fenomen i cili rrezikonte rezervat e shoqërive dhe dëmtonte procesin e pagimit të dëmeve.

Në vitin 2014 vëllimi total i primeve të shkruara bruto arriti në 11.6 miliardë lekë, duke u rritur me 36.1% krahasuar me vitin 2013<sup>2</sup>. Kujtojmë që në vitin 2013 ky tregues në nivel vjetor u ul me afro 4.6%. *Struktura e tregut, përgjithësisht vijon të ketë të njëjtin profil të vërejtur në vite, por me përforcim në tiparin e sigurimeve të detyrueshme.* Sigurimet e jo-jetës përbëjnë 90.9% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg dhe 59.5% e përbëjnë ato të detyrueshme. Primet e shkruara bruto të jo-jetës gjatë vitit 2014 u rritën me 40.5%, ndërkohë që një vit më parë kujtojmë që ato u ulën me 6.5%.

Por paralelisht me stabilizimin e primeve të shitjes së produktit MTPL në treg, është punuar edhe me stabilizimin e procesit të pagimit të dëmeve, sidomos të dëmeve të prapambetura në kuadër të dëmeve që trajtohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

*Në vitin 2014 AMF mori dy masa stabilizuese.* E para lidhet me miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave për pagesën nga rezerva monetare të dëmeve që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit. Në të përcaktohen një sërë rregullash për krijimin, financimin dhe përdorimin e rezervës monetare në shoqëritë e sigurimeve, si dhe çeljen e kryerjen e veprimeve në llogari bankare qëllimore, në funksion të pagimit të dëmeve. Përmbushja e këtyre kërkesave monitorohet nga AMF në bazë mujore.

Masa tjetër stabilizuese lidhet me përcaktimin e nivelit të financimit të fondit të kompensimit në masë të mjaftueshme për të përballuar pagesat e dëmeve të prapambetura. Kështu, vendimi i Bordit të AMF-së mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2014 përcaktoi:

- Totali i dëmeve pezull për t'u shlyer vlerësohej në 1.3 miliardë lekë;
- Pagesat për dëmet pezull deri më 31.12.2013, do të shlyheshin brenda vitit 2016, përkatësisht 430 milionë lekë në vitin 2014, 450 milionë lekë në vitin 2015, si dhe pjesa që mbetet në vitin 2016;
- Pagesat për dëmet pezull do të kryhen sipas vitit të ndodhjes, duke ndjekur parimin që më parë të kryhet pagesa për ngjarjen më të hershme të dëmit të ndodhur, dhe do të përballoheshin sipas peshës në treg të shoqërive për periudhat e pagesave, bazuar në konceptin e nenit 45 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit. Kështu, fondi për përballimin e pagesave për vitin 2014 u përcaktua sipas detyrimeve të krijuara në periudhën e viteve 2001-2009.

Zbatimi i kësaj mase stabilizuese është monitoruar çdo muaj nga ana e AMF-së. Sipas informacionit të marrë nga BSHS, pagesat e dëmeve objekti i Fondit të Kompensimit në vitin 2014 u realizuan në masën 105%. Ndërsa dëmet e krijuara rishtazi (pra gjatë vitit 2014) arrijnë në vlerën totale prej rreth 18.4 milionë lekë dhe prej kësaj shume dëmet e paguara arrijnë në rreth 6 milionë lekë.

---

<sup>2</sup> Krahasimi është bërë me shifrat e raporteve të audituara të vitit 2013.

AMF ka pasur në vëmendje dhe plotësimin e detyrimeve të BSHS-së, lidhur me monitorimin e saj, nga Këshilli i Byrove Bruksel (CoB). Edhe për vitin 2014, BSHS, ka plotësuar kushtet të cilat konsistojnë në: *risigurimin* të një broker i përzgjedhur dhe kontrata e risigurimit është lidhur në përputhje me rekomandimet e CoB, si dhe ekzistenca e *garancisë bankare* në favor të Këshillit të Byrove. BSHS informon periodikisht Këshillin e Byrove për stabilitetin e tregut të sigurimit motorik si dhe pagesat e menjëhershme të dëmeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit karton jeshil. Gjithashtu, Byroja informon çdo muaj Autoritetin për thirrjet e garancisë që raportohen nga CoB. Gjatë vitit 2014, nuk ka pasur asnjë thirrje garancie, gjë që tregon për një përmirësim të performancës së BSHS, lidhur me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil.

Në tregun e sigurimeve pati disa zhvillime të rëndësishme, me ndikime afatmesme.

**Së pari**, në vitin 2014 u miratua ligji për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, një projekt që pritej të përfundohej prej vitesh. Kjo ngjarje hapi rrugën për të zbatuar në praktikë metodologjinë e mbikëqyrjes me fokus rrezikun. Konkretisht, AMF miratoi manualin e mbikëqyrjes me fokus rrezikun, si dhe realizoi inspektimin e parë në një shoqëri sigurimi bazuar në këtë metodë mbikëqyrjeje. Procesi do të vijojë gjatë vitit 2015 me disa shoqëri të tjera sigurimi. Ajo çka paraqet rëndësi është fakti që tashmë AMF ka në zbatim një paketë mbikëqyrjeje nëpërmjet së cilës do të përmirësohet procesi i vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve në kuadër të shoqërisë dhe të tregut në tërësi, duke rritur efektivitetin e procesit mbikëqyrës dhe marrjes së masave mbikëqyrëse.

Një tjetër risi e ligjit janë kërkesat për forcimin e qeverisjes së shoqërive të sigurimit, si dhe ushtrimin të mbikëqyrjes së grupeve. Për të dy këto elemente, por edhe për mjaft kërkesa të tjera që parashikon ligji, janë hartuar dhe po vijojnë të përgatiten një tërësi rregulloresh, të cilat do të plotësojnë kuadrin e nevojshëm për zbatimin e ligjit.

**Së dyti**, në vitin 2014 u miratua ndryshimi ligjor, po ashtu i kërkuar prej vitesh, për përjashtimin e produkteve të tregut të sigurimeve, si produkte financiare, nga aplikimi i TVSH-së. Në këtë mënyrë u hoq disavantazhi që produktet e këtij tregu kishin ndaj produkteve të sistemit bankar, për shkak të rregullimit fiskal.

**Së treti**, sikurse e përmenda më lart, në vitin 2014 ndodhi bashkimi me përthithje i dy shoqërive të sigurimit, që funksiononin prej vitesh në tregun shqiptar me profile biznesi të njëjtë dhe që deri në momentin e bashkimit zinin rreth 18% të vëllimit të primeve të shkruara bruto në tregun e jo jetës, si dhe dominoheshin nga kapitali i huaj austriak. Kjo ngjarje shënon një tjetër fazë e zhvillimit të tregut të sigurimeve, fazën e konsolidimit tij, përmes bashkimit të shoqërive. AMF e vlerëson të përshtatshëm konsolidimin e tregut dhe njëherësh ndjek me vëmendje zhvillimet, që

këto procese të çojnë në përmirësim të konkurrencës; në krijim shoqërisht të cilat janë më të stabilizuara, më eficiente, me struktura organizimi në kuadër grupi më efikase, si dhe në përmirësim të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Jo vetëm kaq, por këto fenomene përdoren në mënyrë aktive nga ana e AMF-së, në përpjekje për të stabilizuar tregun.

**Së fundi**, por jo më pak e rëndësishme lidhet me vijueshmërinë e integritit të regjistrimit të policave me sistemin bankar pranë Qendrës Kombëtare të Dënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, gjë që mundëson zhvillimin dhe kontrollin e tregut të sigurimeve motorike dhe jep mundësinë e krijimit të standardeve në veprimet financiare që nga lëshimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik e deri në pagesën e dëmeve si rrjedhojë e tyre. Gjithashtu, gjatë vitit 2014 përfundoi zbatimi teknik i sistemit *Bonus-Malus*, që bën të mundur tarifimin me bazë rrezikun në sigurimin motorik. Sistemi mundëson edhe integrimin e lidhjes me regjistrin e automjeteve nga i cili shoqëritë e sigurimit mund të marrin të dhënat e mjetit, të cilat e vendosin atë në një kategori të caktuar, e cila nuk mund të ndryshohet. Kjo kufizon mundësitë e abuzimeve dhe gabimeve, duke përmirësuar procesin e lëshimit të policës. Në fund të vitit 2014 u përfundua teknikisht integrimi në kohë reale me regjistrin e popullsisë, i cili ofron numrin personal të pronarit të mjetit si çelës për kërkimin e historikut *Bonus-Malus* dhe kategorizimin e saktë të pronarëve sipas niveleve të rrezikut. Shoqëritë e sigurimit e kanë funksional këtë sistem prej 03/03/2015. Ajo çka mbetet për zbatimin e detyrueshëm të këtij sistemi, është parashikimi në dispozitat ligjore, gjë që kërkon amendimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit.

### 3. Tregu i letrave me vlerë

*Ndërkohë tregu i fondeve të investimeve, në lekë dhe në euro, ka vijuar dinamikën e zgjerimit, duke u shndërruar në tregun e dytë më të madh pas tregut bankar, nga pikëpamja e aseteve. Vlera neto e aseteve të tyre arriti në 63.7 miliardë lekë, që përfaqëson 4.6% të PBB-së, nga 3.7% në vitin 2013. Numri i anëtarëve të të dy fondeve është rritur në 32,669 ose rreth 15% më shumë se një vit më parë.*

Dinamika e zgjerimit të këtyre fondeve tregon interesin që kanë **investitorët vendas për produkte të reja kursimi apo investimi**. Një situatë e tillë favorizohet edhe nga mjedisi me norma të ulëta të interesit, që zbatohen për produktet bankare të kursimeve, mjedisi i cili është mbizotërues prej disa vitesh. Nga kjo pikëpamje, kjo dinamikë zgjerimi është e mirëpritur, sepse nxit zhvillimin e tregjeve financiare, por njëherësh krijon sfida të rëndësishme për t'u përballuar.

Dinamika e shpejtë e zgjerimit të fondeve të investimeve kërkon ngritjen e kapaciteteve dhe përshtatjen e strukturës së AMF-së kundrejt këtyre zhvillimeve. Tashmë AMF po punon për marrjen e vendimeve të shpejta për të plotësuar kuadrin mbikëqyrës.

Me qëllim administrimin sa më të mirë të situatës në jemi në kontakt të vazhdueshëm me BB dhe FMN për diskutimin e problematikave dhe konsultimin e vazhdueshëm të veprimeve, si edhe me anëtarët e GKSF-së, përkatësisht Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Në këtë kuadër, AMF po *përmirëson bazën rregullatore* për fondet e investimeve me dy objektiva kryesorë: (i) forcimin e regjimit të transparencës ndaj klientit / investitorit; dhe (ii) përmirësimin e kërkesave për administrimin e risqeve në treg. Kështu, në vitin 2014 u miratuan rregulloret për fondet e veta; për informacionin kyç që duhet t'i jepet investitorit; përmirësimet në prospektin; si dhe forcimi i rregullave për njohjen e klientit. Po në këtë kuadër është punuar me dy misione të asistencës teknike, me BB për miratimin e regjimit të kërkesave për likuiditetin e fondeve të investimeve, dhe me FMN për vlerësimin e asetëve të fondeve.

Një tjetër zhvillim është *mbikëqyrja e konsoliduar* e këtij tregu, së bashku me Bankën e Shqipërisë në përpjekje për të mbikëqyruar në mënyrë të plotë risqet, veçanërisht ato të depozitarit; ndarjes së asetëve; të forcës shitëse dhe praktikave të shëndosha në shitje etj. Për këtë arsye janë kryer inspektime të përbashkëta me Bankën e Shqipërisë, si dhe nga AMF është kërkuar ndërtimi i një protokolli veprimesh për ushtrimin e mbikëqyrjes së konsoliduar.

Në përfundim, mbetet e rëndësishme *forcimi i regjimit të transparencës dhe edukimit* të konsumatorit, duke pasur në vëmendje risitë që prodhojnë në treg veprimtaritë investuese financiare, me rreziqe jo gjithmonë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatorët. Madje, rreziqet shtohen pasi kohët e fundit janë vërejtur përpjekje të subjekteve të palicencuara nga AMF për të ofruar produkte apo shërbimeve financiare. Kjo dikton nevojën që konsumatori/investitori shqiptar të edukohet që investimet e tij financiare t'i drejtojë vetëm të subjekte financiare të licencuara nga AMF. Një informacion i tillë është lehtësisht i aksesueshëm për këdo në faqen zyrtare të internetit të AMF.

#### **4. Tregu i fondeve të pensioneve private**

*Tregu i pensioneve ka shfaqur një dinamikë rritjeje të njëjtë.* Gjatë vitit 2014, totali i asetëve neto të fondeve të pensioneve private arriti në 629 milionë lekë, me një rritje prej afro 44.7% krahasuar me vitin 2013, si dhe një numër anëtarësh prej 8,491 ose 7.7% më tepër se në vitin 2013.

Zhvillim i rëndësishëm në këtë treg ishte përfshirja e nxitësve të përshtatshëm fiskalë në paketën fiskale të vitit 2015, kërkesë edhe kjo e paraqitur prej vitesh në treg. Efektet e këtyre ndryshimeve i përkasin vitit 2015 e në vijim. Gjithsesi, zhvillimi në tërësi i tregut të fondeve të pensioneve kërkon dhe një sërë faktorësh të tjerë nxitës, që nga formalizimi i ekonomisë deri te elementët e ndërgjegjësimit të kontribuesve, punëdhënës e punëmarrës.



## 5. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Veprimtaria e AMF-së, gjatë vitit 2014, po ashtu është karakterizuar nga dy periudha që diktohen nga miratimi i paketës ligjore të AMF-së. Ndryshimet e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë kanë forcuar në mënyrë të përshtatshme pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e institucionit. Këto rregullime ligjore i japin mundësi AMF-së të ndërtojë kapacitetet e përshtatshme administrative.

Konstituimi përtej afatit ligjor i Bordit të ri vonoi ushtrimin në praktikë të kompetencave të pavarura, në veçanti të ndërtimit strukturor të institucionit, rregullim të cilin po përpiqemi ta përshpejtojmë gjatë këtij viti.

Pavarësisht kësaj, angazhimi dhe përkushtimi në punë i administratës së AMF-së ka qenë i plotë. Të gjitha sfidat që përmenda më sipër kërkojnë që AMF të mbajë dhe të tërheqë personelin e përshtatshëm nga ana e përgatitjes profesionale. Kjo do të thotë që mekanizmi i dhënë nga Kuvendi, në bazë të përcaktimeve të nenit 9 të ligjit, do të duhet të përdoret pa rezerva, duke respektuar kriteret ligjore.

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së AMF-së janë angazhimi në kuadër të marrëdhënieve me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe angazhimi me projektet e asistencës teknike. Autoriteti është pjesë aktive e komiteteve dhe nënkomiteteve apo organeve të tjera në kuadër të tre organizatave ndërkombëtare të mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensione, përkatësisht IAIS, IOSCO dhe IOPS. Me këto organizata ka edhe një marrëdhënie intensive në përgatitjen e dokumenteve të ndryshëm, politikë, studimorë, pyetësorë etj.

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Austrisë (FMA), si dhe autoritete të tjera të mbikëqyrjes të rajonit të Evropës Lindore e Qendrore, por edhe të tjera si Autoriteti Federal i Mbikëqyrjes Financiare (BaFin) të Gjermanisë, përbëjnë një grup autoritetesh mbikëqyrëse e rregullatore me të cilat AMF ka marrëdhënie të vazhdueshme dypalëshe dhe në kudër iniciativash të grupeve në funksion të forcimit të kapaciteteve dhe të shkëmbimit të përvojës. Me FMA marrëdhëniet zhvillohen edhe në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit. Në vitin 2014, AMF organizoi një takim dyditor për dhënie përvojë për autoritetin e mbikëqyrjes së sigurimeve në Gjeorgji.

Në vitin 2014 AMF filloi dy projekte të rëndësishme të asistencës teknike, si dhe zhvilloi punën përgatitore për nisjen e një projekti të tretë në vitin 2015. Këto tri projekte kanë një objektiv të përbashkët forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse e rregullatore të AMF-së për secilin prej tregjeve që mbikëqyr AMF. Prandaj, roli i AMF-së në të tri projektet është mjaft aktiv, pasi detyrat që duhet të përmbushen, si dhe burimet e vëna në dispozicion, janë të konsiderueshme.



Më konkretisht,

***Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve*** ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe është strukturuar në tre komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. ***Sigurimi i produktit MTPL.*** Në këtë komponent synohet të hartohen kërkesa rregullatore për përcaktimin e rezervave për produktin MTPL, që janë të përshtatshme nga ana aktuariale dhe për t'i inkuadruar ato me praktikatat e mbikëqyrjes në vend. Objektivat e këtij komponenti janë: (i) të sigurohet për konsumatorët kryerja e pagesave të duhura dhe në kohë në lidhje me dëmet për produktin MTPL; (ii) të zbatohen me paanshmëri rregullat për produktin MTPL; dhe (iii) të sigurohet vlerësim i përshtatshëm i aftësinë paguese për të gjitha shoqëritë e sigurimit.
2. ***Mbikëqyrja e sigurimeve të përgjithshme.*** Në këtë komponent synohet zhvillimi i kuadrit ligjor në zbatim të ligjit të miratuar për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, paketës së manualeve të mbikëqyrjes në vend dhe kuadrit rregullator për sigurimin e jetës. Objektivi i këtij komponenti është forcimi i kapacitetit mbikëqyrës institucional të AMF-së.
3. ***Programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet.*** Në këtë komponent synohet plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore me elementët e sigurimit nga tërmeti. Objektivat e këtij komponenti janë: (i) Mbështetja e stabilizimit të tregut të sigurimeve, duke reduktuar ndikimet negative në likuiditetin e shoqërive të sigurimit që krijohen nga reforma në sigurimin e MTPL; (ii) Kontribuimi në zhvillimin dhe rritjen e shëndoshë të sektorit të pazhvilluar të sigurimeve; dhe (iii) Reduktimi i konsiderueshëm i ekspozimit fiskal kundrejt humbjeve që pësohen nga ngjarje tërmetesh të forta.

***Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen pensioneve*** ka një kohëzgjatje prej 16 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. ***Rregullimi dhe mbikëqyrja.*** Në këtë komponent objektivi është të hartohet kuadri i mbikëqyrjes me bazë rrezikun, si elementi bazë për zbatimin e kësaj metodologjie mbikëqyrjeje në fushën e pensioneve.
2. ***Zgjerimi i tregut të pensioneve.*** Objektivi në këtë komponent është zgjerimi i mbulimit me pensione të punëmarrësve në Shqipëri.

***Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve*** ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve.* Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualët dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore.
2. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t'u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore.* Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

Të tre projektet kanë komponent të rëndësishëm rishikimin e bazës ligjore për tregjet që mbikëqyrin. Në AMF po punohet me amendimet e tre ligjeve, përkatësisht të ligjit për fondet e pensionit vullnetar, për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe për sipërmarrjet e investimeve kolektive, me synim paraqitjen e tyre për miratim në vitin 2015. Ligjet e tjera, kryesisht ato që kanë të bëjnë me tregun e kapitaleve, do të rishikohen në vitet pasuese. E përmenda këtë fakt për të sjellë në vëmendjen tuaj që përmbushja me sukses e detyrave të projekteve do të kërkojë në vitin 2015 e në vijimësi mbështetjen e Kuvendit në procesin e diskutimit dhe miratimit të ligjeve me synim nxitjen e stabilitetit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Në vitin 2015 është përcaktuar si objektiv i rëndësishëm forcimi i bashkëveprimit me industrinë dhe ministrinë e linjës për ti shërbyer zgjerimit të tregjeve. Kështu, është studiuar dhe po punohet për konkretizimin e propozimeve në lidhje me zgjerimin e tregut të sigurimeve, duke prezantuar një gamë produktesh të sigurimit të përgjegjësive profesionale, sipas praktikave që hasen në tregje të tjera. Po punohet për shqyrtimin e shkallës së njohurive dhe reagimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve në raport me pjesëmarrjen e tyre në fondet e pensioneve vullnetare. Të gjitha këto veprimtari pritet të japin frytet e tyre për zgjerimin e tregjeve në një periudhë afatmesme.

Duke Ju falënderuar për vëmendjen tuaj,